

20250671402

МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА, ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ

Në bazë të nenit 17 paragrafi (3) të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 24/21, 39/25), ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë miratoi:

R R E G U L L O R E **PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E UDHËHEQJES SË REGJISTRIT TË** **PERSONAVE TË TRAJNUAR PËR ZBATIMIN E EDUKIMIT FILLESTAR DHE TË** **VAZHDUESHËM MBI DHUNËN NË BAZË GJINORE NDAJ GRAVE DHE DHUNËN NË** **FAMILJE**

Lënda

Neni 1

Kjo rregullore përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së Regjistrit të personave të trajnuar për realizimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje (në tekstin e mëtejshëm: Regjistri).

Neni 2

Regjistri udhëhiqet në formë të shkruar dhe elektronike.

Regjistri udhëhiqet në formë të shkruar si libër i posaçëm me kopertinë të kuqe, në format A4, bashkangjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Regjistri udhëhiqet edhe në formë elektronike bazuar në një program të përgatitur aplikimi.

Të dhënat nga paragrafi 3 i këtij neni mbrohen nga ndryshimet e paautorizuara në përputhje me parimet e mbrojtjes elektronike të të dhënave.

Neni 3

Regjistri në kopertinë përmban stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, titulli: “REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT, MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE RINISË” dhe titullin “REGJISTRI I PERSONAVE TË TRAJNUAR PËR KRYERJEN E EDUKIMIT FILLESTAR DHE TË VAZHDUESHËM PËR DHUNËN NË BAZË GJINORE NDAJ GRAVE DHE DHUNËN NË FAMILJE”.

Faqja e parë e Regjistrit përmban 12 rubrika, përkatësisht: numri rendor; lloji i edukimit (fillestar/vazhdues); emri dhe mbiemri i personit të trajnuar për të kryer edukimin mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunën në familje; gjinia; të dhënat kontaktuese (adresa, numri i telefonit dhe e-mail adresa); lloji dhe shkalla e arsimimit; institucion/organizatë ku personi është i punësuar/vullnetar ose konsulent i pavarur; data e lëshimit të certifikatës së trajnimit të kryer për trajner; organizata që ka lëshuar certifikatën për kryerjen e trajnimit për trajnerë dhe Programi i Trajnimit; numrin dhe datën e regjistrimit në regjistër, numrin dhe datën e fshirjes në regjistër; vërejtje dhe nënshkrimi i nëpunësit zyrtar.

Çdo faqe e Regjistrit shënohet me numër rendor. Faqja 1 përsëritet deri në faqen 100.

Neni 4

Shkrimi i të dhënave në regjistër bëhet me me ngjyrë blu të errët.

Në rast të shkrimit të gabuar, korrigjimi bëhet në atë mënyrë që mbi tekstin e futur gabimisht të vizatohet një vijë e hollë me bojë të kuqe, në mënyrë që të dhënat e futura gabimisht të mbeten të lexueshme dhe teksti i saktë të futet sipër tij.

Çdo regjistrim në regjistër nënshkruhet nga nëpunësi zyrtar që e drejton Regjistrin.

Neni 5

Kjo Regullore hyn në fuqi nga dita e publikimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.17-2711/1
26.3.2025
Shkup

Ministri i Politikës Sociale,
Demografisë dhe Rinisë,
Fatmir Limani, d.v.



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E POLITIKES SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE RINISË

REGJISTRI I PERSONAVE TË TRAJNUAR PËR ZBATIMIN E EDUKIMIT FILLESTAR DHE TË VAZHDUESHËM PËR DHUNËN NË BAZË GJINORE NDAJ GRAVE DHE DHUNËN
NË FAMILJE

[illegible]

Faqja 1 përsëritet deri në faqen 100.